



**KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



PROCESVERBAL VI/2022

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 6 (gjashtë) për vitin 2022 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

**Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 29.06.2022
Ora: 10.00**

Prezentë në takim:

**Z. Shefket Kolgeci
Z.Selman Kolgeci
Z. Flamur Bytyqi
Z. Urim Suka
Z. Kushtrim Kuçi
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj.Doruntina Zenelaj
Z.Alban Berisha
Z. Bexhet Kuçi
Z. Reshat Selimaj
Z. Lirim Qatani
Z. Aziz Bytyqi
Znj.Sanie Kuçi
Rexhepaj
Znj.Mimoza
Bajrakatari
Znj.Fidaije Kukaj
Znj. Afërdita Morina
Znj.Saranda Bajraktari**

Të pranishëm të tjerë

**Z. Driton Maliqaj
Z. Xhevshet Gashi
Z.Edon Sadikaj
Z.Dardan Berisha
Z.Bajram Basha
Znj.Mevlude Kabashi
Znj.Sheqerije Zyrapi
Znj.Laureta Tafaj
Z.Liridon Fandaj
Z.Qëndrim Elshani
Znj.Festë Kabashi
Z.Herolind Limaj
Znj. Jehona Rrafshi**

**Kryetari Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi.

Rend dite

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës publike të Komunës;**
3. **Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave publike të Komunës;**
4. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Strategjisë për Informim dhe Komunikim;**
5. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-31919;**
6. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për komunën e Suharekës për vitin 2023-2025;**
7. **Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit dhe i njofton me rendin e ditës. Kryesuesi kërkon që pika 5 të tërhiqet nga rendi i ditës.

Kryetari - përshëndet të pranishmit. Vitin e kalum ka qenë e njejtë qeveri, i njejtë ministër dhe e njejtë rregullore. Ata kanë mendu që na e kem tejkalu 200 mijëshin. Kanë mendu që në tri vite kem dhanë nga 80 mijë, e që me ligj 200 mijë mundesh mi nda dhe kjo është arsyeja pse është kthyer. Sot kemi bisedu me Ministrin dhe presim përgjigje pozitive.

Kryesuesi - ata kanë kërku që kjo pikë të tërhiqet për momentin deri sa të sjellin një vendim tjetër Ministria e Pushtetit Lokal.

Qëndrim Elshani - kërkoj sqarime nga zyrtari ligjor. A kemi pas të drejtë mi dhanë këto fonde dhe a është e udhës për me tërheq tash për me i zgjat procedurat.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime.

Urim Suka - është situatë e re dhe ju shumicën e rasteve na befasoni me këso situata, por sido që të jetë, mënyra se si po e arsyetoni, le të presim. Por është dasht mu bo ky komunikim ma herët, para se me ardh në rend dite.

Kryetari - e njejtë qeveri, të njejtat ligje n'fuqi, vitin e kalum është aprovu dhe sivjet s'është aprovu.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5 për me tërheq nga rendi i ditës.

**15 për, 8 kundër, 2 apstenime
Miratohet**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës pa pikën 5.

**16 për, 10 apstenime
Miratohet**

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - nuk ka vërejtje në procesverbal, Kryesuesi e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës publike të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Shefket Kolgeci - përshëndet të pranishmit dhe thotë që ka vërejtje te ky projektvendim. Projekt-vendimi 1.1 veq funksionon dhe jemi në dijeni, por kërkojmë nga Drejtoria e Urbanizmit sqarime shtesë për pikën 1.2 dhe 1.3. Gjithëashtu kërkojmë që pika 1.2 dhe 1.3 të shkoj me një projekt-vendim veq.

Kryetari - ju si Asamble Komunale pa dallime politike mundeni me propozu, por ne e kemi obligim me qit në anakand. Dy parcelat tjera janë toka bujqësore, janë nën autostradë dhe më mirë mi dhanë në shfrytëzim se me i lan vjerrina. Jepne propozimin për sa vjet, ka mu shpall ankand publik, hyni në komision dhe vendosni. Dy tjerat nuk kemi drejtë mi dhanë më shumë se 10-15 vite.

Shfket Kolgeci - pse mos mi dhanë edhe dy tjerat për 99 vite.

Kryetari - s'kemi të drejtë.

Kryesuesi - jep sqarime shtesë rreth kësaj pike.

Aziz Bytyqi - meqë është duke funksionu, për pikën 1.1 propozimi i jonë është me dhanë 30 vite.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime rreth procedurave të pronave publike të Komunës.

Liridon Fandaj - edhe unë jam i mendimit që pikes 1.1 ti zgjatet afati jo 30 por 40 vite, pasi është biznes funksional. Pika 1.2 dhe 1.3, kisha kërku sqarime se a kanë qasje këto parcela .

Armend Krasniqi - këto parcela nuk kanë qasje në rrugë dhe këto prona po ipen si prona bujqësore.

Selman Kolgeci - çka nëse kompania që e fiton dështon mas dy tre vjetëve.

Avni Bytyqi - pas aprovimit të rekomandimit të komisionit nga ky Kuvend në bazë të ligjit dhe rregullorës Kryetari i Komunës ka për obligim që të nënshkruaj kontratën me përfituesit e pronës dhe ti përcakton obligimet dhe detyrimet që kanë ndaj njëra tjetrës. Dhe ne në kuadër të kontratës i parashohim disa kushte që ai ka mi plotësu për një periudhë. Me që kërkuat që të ndahen këto parcela, atëherë parcela 1.1 e fashatit Mushtisht tërhiqet nga ky projekt-vendim dhe mbeten në këtë projekt-vendim parcelat në Reshtan.

Kushtrim Kuçi - unë sugjeroj që parcelat 1.2 dhe 1.3 të jepen për 15 vjet.

Kryesuesi - i hedh në votim parcelat 1.2 dhe 1.3 për 15 vite shfrytëzimi.

Unanimisht Miratohet

Avni Bytyqi - pika 1.1 kalon te projekt-vendimi ku Kuvendi jep pëlqimin për të zhvilluar procedurat e konkurimit të hapur. Duhet të përcaktoni afatin ligjor sa. Dikush tha 30 dhe dikush 40 vite.

Kryesuesi - a jeni të pajtimit për 35 vite. Pajtohen të gjithë. Kryesuesi e hedh në votim.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronave publike të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - lidhur me këtë projekt-vendim, ne në parim jemi që zona Industriale të zhvillohet. Duke e pare e analizuar veprimet tuaja gjatë gjithë këtyre proceseve shihen qartë një qasje e juaja për të mbrojtur interesat tuaja të ngushta dhe të një rrethi të ngushtë rreth jush. Duke e ditur që ju komisionin për dhënie në shfrytëzim të pronës publike dhe komisionin e ankesave e keni caktuar me njerëz tuaj, duke anshkaluar opozitën përkundër që ligji e thotë që në këto komisione anëtarët duhet me qenë nga subjekte të ndryshme dhe duke e ditur rastin e fundit kur i detyruat asambleistët tuaj të votojnë kundër projekt-vendimit në rastin Bleta, ne kemi dyshimet tona, prandaj nuk e mbështesim një projekt të tillë.

Kryesuesi - e hedh në votim.

**14 për, 8 kundër, 1 apstenim
Miratohet Pika 3.**

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Strategjisë për Informim dhe Komunikim;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - çdo përpjekje që ka për qëllim informimin e qytetarëve me vendimet e angazhimet që Komuna ka, është e mirëseardhur. Kjo strategji ashtu edhe si dokumentet tjera që po hartoni e miratoni, shumica prej tyre nuk po implementohen sipas asaj që po planifikohen. Kur jemi te strategjia për informim e komunikim nuk mundem pa adresu faktin që Komuna jonë është renditur si Komuna me transparencë të ulët nga KDI, ndërsa sot kur e analizojmë këtë dokument që ju keni sjellë për miratim, shihet që ju nuk keni gadishmëri as minimale për të rrit transparencën, pasi ky dokument është më shumë një përshkrim se sa një dokument që parasheh hapa konkret që do të ndikojnë në informimin e drejtë të qytetarëve. Fakti që Komuna jonë renditet në mesin e Komunave me transparencë të ulët, vërteton atë që them në vazhdimësi për ju. Se ju nuk po qeverisni në interesin e të gjithë qytetarëve por po qeverisni në interes të një rrethi të ngushtë të oborrit tuaj qeveritar. Dua të theksoj që informimi, komunikimi, transparenca më shumë se sa strategji është vullnet që një pushtet duhet të ketë, e këtë vullnet ju s' e keni. Në këtë strategji shihet qartë që ju se keni vullnetin për të rrit transparencën e informimin e drejtë të qytetarëve, pasi që punimet e këtij Kuvendi, aty ku qytetarët përfaqësohen nga të gjitha partitë nuk parashihen të transmetohen me profesionalizëm tek qytetarët. Ne mendojmë që kjo strategji përveq tjerash duhet të adresojë edhe qështjen e transmetimit në mënyrë sa ma profesionale të seancave të Asamblesë tek qytetarët. Të shtohet numri i kamerave në sallë, të rritet kualiteti i inqizimit të seancave si dhe të transmetohen në kohë reale këto seanca nga portale serioze lokale me qëllim të informimit sa ma të drejtë të qytetarëve. Nëse mirren parasysh shqetësimet tona, ne mund ta miratojmë këtë strategji pas plotësimeve të nevojshme.

Qëndrim Elshani - u bo një kohë kur kam reagu për qështjen e transmetimit të seancave e cila lidhet ngushtë me qështjen e transparenës dhe startegjisë së informimit dhe komunikimit. Besoj që jemi të pajtimit krejt që seancat nuk duhet me vazhdu me u transmetu vetëm me këtë kamerë të sigurisë këtu nalt. Nëse Kuvendi Komunal nuk ka kontraktuar asnjë kompani për transmetimin e seancave, të paktën besoj që jemi krejt të pajtimit që së pari me u rregullu ajo kamerë nalt dhe mi vendos nja dy tre kamera në seance që shihet kush çka po thotë dhe kush çka po voton. Kisha kërku që edhe në komisione me pas kamera, të paktën në KPF.

Kryesuesi - unë sot e bisedova me Yllin, pikërisht idenë tënde dhe besoj shumë shpejt kemi mi vendos dy kamera mbrapa dhe dy zmadhues të zërit.

Urim Suka - gjysmën e asaj që kërkova, ju e dhatë sqarimin por nuk e sqaruat se a do të mund të transmetohen seancat në kohë reale nga portalet serioze apo naj medium në nivel lokal. Duhet të merret seriozisht sepse nuk ka ndonjë kosto të madhe me bo një lloj bashkëpunimi me portalet serioze dhe me adresu këtë qështje.

Reshat Reshitaj - Përshëndet të pranishmit. mendoj që nuk është problem transmetimi i seancave. Ai po transmetohet përmes kanlit you tube që këto portalet serioze që i quani ju, ato munden shumë lehtë me marrë, sepse seancat transmetohen gjithmonë në kohë. Televizionet kombëtare nuk vin me transmetu sepse i kanë kostot e mëdhaja, ndërsa televizionet lokale nuk di sa po përcillen. Ma tepër po përcillet një kanal në you tube apo facebook. Por sido qoftë nëse është kërkesa e juaj, prap i nisim procedurat.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4, duke marrë parasysh shqetësimin e Qëndrimit, që seancën e radhës ti kemi dhe dy kamera mbrapa dhe dy zmadhues.

16 për, 6 kundër, 3 apstenime
Miratohet Pika 4

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për komunën e Suharekës, për vitin 2023-2025;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Selman Kolgeci - për këtë pikë kërkoj nga Drejtori i Financave të jep më shumë sqarime rreth këtij dokumenti. Si ka mundësi që nuk është planifikuar asnjë emër i përveqëm i rrugëve dhe si ka mundësi që nga dy apo ma shumë projekte janë fut në këtë kornizë dy here? Besoj që edhe ju vet e dini që po na servoni një dokument që në përmbajtje ka elemente të paqarta, ju jep mundësi ta keqpërdorni autoritetin duke i orientuar investimet ka të doni ju dhe është kundërthënës me strategjinë e zhvillimit lokal të sjellur e të miratuar nga vet ju. Problemi i mos vendosjes së saktë të investimeve në emërtime nëpër rrugë po vazhdon të mbetet njollë e paaftësisë tuaj qeverisëse dhe reference e dyshimit të keqmenaxhimit, të keqpërdorimit të parasë publike. Ju nga gjitha investimet në rrugë nëpër fshatra i keni quajtur ndërtimi i rrugëve lokale, gjë kjo e cila nuk është profesionale dhe ju lë vend për të vazhduar autoritetin duke vazhduar akoma që jashtëligjshëm në emër të ndërtimit të rrugëve të ndërtoni oborre private e rrugë poersonale të mbështetësve e bashkëpartiakëve tuaj. Si do ta arsyetoni sot këtë mungesë të emërtimeve të rrugëve nëpër fshatra? Si do ta arsyetoni këtë paaftësi për përpilimin e një dokumenti kaq të rëndësishëm e që gjatë realizimi të tij mund ta derivojë një sere shkelje ligjore? Pse nuk po ndërmerri hapa për themelimin e një komisioni për emërtimin e rrugëve e cila është kërkesë e qytetarëve. Padyshim që kjo do ta parandalonte keqpërdorimin e buxhetit sepse

investimet do të bëheshin sipas emrave të rrugëve. Për ndërtimin e Komunës keni planifikuar deri në vitin 2025 250 mijë euro dhe nëse nuk keni marrë ndonjë garancë nga një ministri apo organizatë e huaja për përkrahje në këtë projekt, vlera të cilën e keni nda tregon qartë se nuk e keni seriozisht ndërtimin e objektit të Komunës. A do të vendosni prap panele ndriçuese që bin në tokë e që rrezikojnë qytetarët e i quani smart? Nëse po, jeni jashtë temës dhe ky projekt e dini mirë që nuk është smart. Në strategjinë që keni sjell vet dhe e keni miratu vet, keni thënë që po planifikoni investimin e 500 mijë euro në ndriçimin publik me solar, ndërsa sot në këtë kornizë keni planifikuar sanimin e ndriçimit publik për vitin 2023 në vlerë prej 100 mijë euro. A është kjo në kundërshtim me strategjinë e zhvillimit, apo po e pranoni që strategjia e zhvillimit ka qenë një mashtrim i radhës që iu është servuar qytetarëve e anëtarëve të Kuvendit. Kur ne kishim kërkesë për sistemin e ujësjellësit në Vraniq, ju zoti Muharremaj keni deklaruar se ajo është kompetencë e hidroregjonit ndërsa tani keni planifikuar ndërtimin dhe rregullimin e infrastruktures së ujësjellësit në Komunë 280 mijë euro për vitin 2023 dhe reth 1.1 milion deri në vitin 2025. Pyetja është: A nuk kishit atëherë informacion kur keni deklaruar se nuk është kompetencë e juaja apo keni pritur të fitoni kohë? Në këtë kornizë ka projekte të cilat janë në zhvillim e sipër procedurat e prokurimit, e ju prap i keni futur në investime kapitale për vitin 2023. Këtë kornizë afatmesme buxhtore e përbëjnë edhe shumë projekte tjera të ngjashme me elemente të theksuara të dyshimit të keqpërdorimit të parasë publike, dhe si e tillë mendoj që nuk duhet të votohet.

Kryetari - në mënyrë publike e kam thënë, edhe në Asamble Komunale dhe në debate publike, që nuk merrem me probleme të ujësjellësit të fshatit Vraniq, për arsye se është formu një komision nga Asamblea Komunale, dhe kanë thënë që na kem me kry. Kur të dojnë kryesia e fshatit Vraniq muji me bo marrëveshje me hidroregjionin. Prap po them se është kompetencë e hidroregjionit për ujë dhe kanalizim. Ne si Komunë e kemi obligim me nda çdo vit mjete, mirëpo ato mjete shkojnë me bashkëfinancim me hidroregjionin dhe hidroregjioni i kryen procedurat ligjore. Kryetari tutje i përgjigjet edhe pyetjeve tjera dhe jep sqarime.

Selman Kolgeci - thatë që është formu komisioni për Vraniq, por nuk është problemi veq me ujë por është problem edhe shtrirja e ujësjellësit. Te ndërtimi i rrugëve lokale pe përmend Samdraxhën dhe Mushtishtin, por secili fshat e ka ndërtimi i rrugëve lokale.

Labiot Halitjaha - përshëndet të pranishmit. Ne si drejtori dhe si Komunë për vitin 2023 kemi parapa një buxhet prej 19.807.625 euro. Ne si drejtori prej datës 1 qershor deri me 11 qershor kemi dalë nëpër gjithë fshatrat e Komunës në dëgjime publike dhe të gjitha kërkesat, sugjerimet i kemi marrë, i kemi të shkruar. Në këtë pjesë të KAB-it nuk i kemi përcaktuar për shkak të disa problemeve në pjesën e rrugëve që janë duke u shtrur dhe janë shtrur. Mendojmë që në pjesën e dytë të kornizës do të përcaktohen të gjitha këto rrugë me emra.

Selman Kolgeci - po thoni që komisioni është funksional. Unë kërkoj mu funksionalizim. Ka shumë kërkesa të qytetarëve për emrim dhe riemrim.

Kryetari - nuk është funksional. E ka përmbyll në fund të vitit 2017 komisioni punën që ka punu 4 vite radhas. Ato kan kalu në Asamble dhe është ligji në fuqi. Nuk muji na kur dojmë me formu komisione për emrimin e rrugëve.

Avni Bytyqi - qështja e emërimit të rrugëve dhe emërimit të sistemit të adresave është e rregullune me ligjin për sistemin e adresave dhe janë një varg udhëzimesh administrative. Në vitin 2015 është miratu nga kuvend vendimi për emërimitin e sistemit të adresave në territorin e Komunës së Suharekës. Ka pas ankesa shumë dhe komisioni i forumit nga Kuvendi i ka shqyrtu dhe në kuadër të vendimit e kemi qit një nen që Komuna nuk ka drejtë në periudhën prej 10 vjeqare të bën plotësim ndryshim të emërimit të rrugëve, ndërsa qështja e adresave të reja është kompetencë e Drejtorisë së Urbanizmit.

Festë Kabashi - përshëndet të pranishmit. Me gjithë respektin por ka qenë për keqardhje pjesmarrja e ulët e asambleistëve në dëgjimet publike të organizura në Komunën tone. Unë dhe kolegu Liridoni kemi qenë në disa dëgjime publike dhe vërehet qartë se kërkesat e banorëve nuk janë përfshirë në KAB për periudhën 2023-2025. Mospërputhje ka edhe tek vlera e shumës së paraparë për investim në fshatra të caktuara. Psh. kemi raste në fshatin Bukosh, ndërtimi i rrugëve lokale, ku në dëgjim është thënë që është parapa vlera 45 mijë euro ndërkaq këtu e kemi 50 mijë euro, pastaj kemi rastin e Gjinocit, dhe kemi prap dallim 5 mijë euro, kemi fshatin Mushtisht nga 90 mijë euro në 100 mijë euro, kemi rastin në fshatin Stravuqin nga 20 mijë euro në 50 mijë, pastaj kemi edhe rastet e investimit të parapara në Komunë. Meqë e keni pasur të pranishëm zyrtaren nga Komuna për mbajtjen e procesverbalit, për hire të korrektësisë dhe transparencës do të ishte mirë që ato procesverbale të na dërgoheshin për seancën e sotme si material dhe do ti shihnim kërkesat e qytetarëve dhe sa janë marrë parasysht nga pozita. Nga kjo kuptojmë që dëgjimet janë mbajtur formalisht dhe nevojat e qytetarëve tanë janë shpërfillur.

Kryetari - ato që janë folur në dëgjime publike janë të skanune dhe janë të publikuara në web faqen e Komunës. Buxheti i vitit të kalun ka qenë rreth 17 milion euro dhe këtë vit e kemi 19 milion. Kjo kornizë nuk është e thënë që kalon krejt, për arsye se ne kem kërku ma shumë mallra dhe shërbime, për arsye se disa punë nuk kryhen me investime kapitale. Tash vje qarkorja e dytë dhe ata vendosin sa mallra shërbime, sa paga meditje dhe sa investime kapitale. Këto mjete që vendosen nëpër fshatra destinohen në ato fshatra.

Festë Kabashi - ne në dokument kemi edhe raste të cilat janë në minus,por patëm dëshirë mi përmend vetëm ato që janë në plus.

Urim Suka - KAB është një dokument i rëndësishëm që ky Kuvend merr për ti dhënë drejtim investimeve strategjike për tri vitet e ardhshme.Mirëpo kur sheh se si ky dokument është përgaditur e sjellur në Kuvend e kupton qartë joseriozitetin që ky pushtet ka në adresimin e kërkesave të qytetarëve .Habitem,si mund ti kërkon kuvendarëve që të miratojnë këtë dokument, si mund ta qojnë dorën kur në të nuk figurojnë as informatat minimale që ky dokument duhet të ketë.Projektet që keni parapa në të gjitha fshatrat janë vetëm rrugë lokale.Pyetja është,cilat rrugë?Këto vendbanime kanë nevoja edhe për projekte tjera dhe jo vetëm rrugë lokale.Kryetar Muharremaj,ti po kërkon që kuvendarët me miratu këtë kornizë për të cilën as ti nuk e din çka parashihet në të.Banorëve të Samadraxhës iu drejtuar duke i thënë që keni hartuar një kornizë buxhetore dhe për Samadraxhën e keni planifikuar një shkollë të re.Tani të ftoj të na trgosh ku e shkollën e Samadraxhës në këtë kornizë.Dua të di ,kjo kornizë çka parasheh për shkollën 7 Marsi,çka parasheh për shkollën në Reqan,çka parasheh për shkollën në Maqitevë,etj.Lidhur me bujqësinë,në këtë kornizë figuron që për vitin 2022 keni nda buxhet 976.989 euro.Si duket bujqësisë me një vendim ia keni marrë 470 mijë euro.Dil dhe trego sa është buxheti për bujqësinë për vitin 2022.Çka do të bëhet me shtëpinë e kultures?Cilat do jetë mbështetja për sportin dhe sportistët në këtë kornizë?Cila është mbështetja për artin e artistët?Pse figuron dy here ndërtimi i shtëpisë së kulturës në Samadraxhë?Ky dokument si i tillë nuk duhet votuar.Kjo kornizë do të duhej të adresonte problemet konkrete të qytetarëve,me emra konkretë të projekteve,pastaj mbi bazën e këtyre të dhënave ne të debatonim e të jepnim propozimet tona për rrugët që duhet shtruar e projekte tjera që duhet realizuar.Vota jonë është kundër dhe ftoj gjithë kuvendarët që mos ta mbështesin këtë kornizë.

Kryetari - atë që e premtoj çdo here në jetë e kam realizu dhe ka me realizu.Te bujqësia, afërsisht janë 1 milion euro,por na i zbatojmë ligjet që janë në fuqi.I ka hek qeveria.Shumë shpejt ka me të ftu, dhe ti ki me nis gurëthemelin në Samadraxhë dhe të gjithëve ka me ju ftu.Tenderi është shpall por nuk di a është përcaktu fituesi.Kryetari tutje jep sqarime.

Urim Suka - dua të jem konkret.Në kornizën që e ki pru,sot figuron 976.989 euro buxheti,por vendimin që kemi marrë para dy muaje 470 mijë euro ja ke hek.Kallzona,a janë 976 mijë a janë ma pak.Për Samadraxhë ke planifiku shkollë të re,qu kallzo ku e ki shkollën në kornizë.Performaca nuk thashë që u kanë e parafundit por thashë që ka dalë e ulët.Unë po du me ditë,ku e kam një kornizë me emra konkret të rrugëve,dal e kqyri a është prioritet,foli me qytetarë,vi dhe jap propozime këtu dhe e miratojmë një kornizë që është e mire.Jeni jo serioz,jeni jo transparent.

Kryetari - shkolla nuk është në kornizë,është shpall tenderi,gjendet përfituesi dhe fillon.më duket i ke ngatërru gjanat.Nuk jemi tu fol për këtë vit por për vitin e ardhshëm.Shtëpia e kultures për qytet është në OSHP në Prishtinë.

Reshat Selimaj - përhëndet të pranishmit.Dua të ndërlihem me dy shqetësimet e Selman Kolgecit,njëri te komisioni i rrugëve.Dua të kyqem për shkak se kam qenë 8 vite në këtë komision.Në komisionin e pare mbi 95 % e rrugëve i kemi aprovu në Asamble.Për komisionin e ri,4 vjetët e shkuar,neve e kemi themelu, por komisioni funksionon kështu:Agjensioni kadastral në bashkëpunim me Ministrinë e Planifikimit dhe Drejtorinë e Urbanizmit komunikojnë ndër vete.Duhet ti njoftojmë qytetarët që aty ku është da rrugë ndërmjet vllaznive duhet me shku në katastër dhe mi dhanë rrugës numër.Kurse sa i përket shqetësimit në Vraniq,në mandatin e kalum keni formu një komision dhe me pëlqimin e Kryetarit ka qenë kështu: shkoni dhe bëni marrëveshje me dy fshatrat dhe unë e ekzekutoj.I kemi taku dhe i kemi lut,ka dallime.Sa i përket fshatit Vraniq ata nuk janë të interesun dhe të gatshëm të hyn në hidroregjion.Sa i përket debateve publike,asnjëri nuk e japim kontributin në debate publike por vërejtjet janë maksimale.A ke qen prezent në Bllacë?

Urim Suka - si po mendoni na me ardh në dëgjim publik, dhe ju me na kallzu përralla,dhe me ardh me pru këtë kornizë, ku as nuk e lexoni vet.Asnjë kërkesë të qytetarëve nuk e keni fut në kornizë.

Reshat Selimaj - Urim,të gjithë ata që kan marrë pjesë në debat publik kanë të drejtë dhe ti nuk ke të drejtë.Është dasht me shku me ngrit shqetësime atje dhe mi dhan interesat e fshatit tend.

Selman Kolgeci - buxhetin se ka ngatërru Urimi por buxhetin e ka ngatërru Kryetari,edhe atë qëllimisht.

Te qështja e emrave të rrugëve,unë kërkova me u themelu komisioni pasi e kanë kry mandatin,dhe unë thashë e kanë kry punën e vet komisioni.Thashë ka shumë emra të rrugëve që janë të deponume në drejtorinë e Urbanizmit dhe kërkesa ishte për emërim,riemërim e rrugë të reja.Te ujësjellësi në fshatin Vraniq,unë e potencova dhe thashë që nuk është problem vetëm furnizimi me ujë,por edhe rrjeti i ujësjellësit.

Reshat Selimaj - fshati yt nuk është i gatshëm me ja dorëzu hidroregjionit.Ne e kemi pranu investimin dhe sot e menagjon fshatin tone hidroregjioni .

Urim Suka - Kryetar,dallimi mes meje dhe teje është se ti del dhe thu fjalë qysh t'vin vet dhe unë e tham mbi bazën e dokumentave që ju vet e keni sjell.Unë thashë që se ke lexu dokumentin dhe e vërtetove se ja huqe krejt shifrave që unë i thashë.Viti 2022, janë 976.989 euro për bujqësi.Dhe për këtë të pyta,a i ki kaq apo ma pak.

Kryetari - debatet janë të mira,kritikat janë të mira.Jemi tu bisedu për vitin 2023.

Ardian Kotorri - përshëndet të pranishmit. Dua të sqaroj që kur të bëhet korniza afatmesme buxhetore në projektion qitet sa kanë qenë për këtë vit, planifikimi për vitin e ardhshëm dhe dy projeksonet e tjera për vitin 2024-2025 shkojnë të bujqësia. Planifikimi për vitin e ardhshëm është 1 milion euro.

Urim Suka - vetëm për 2022 trego. A i ka 976000, a i ka ma pak?

Ardian Kotorri - nuk mundesh me hek sepse kjo kështu ka qenë e planifikime në buxhet. Jep sqarime edhe rreth debatit publik të Kryetarit në Samadraxhë, ku Kryetari ka thënë që jemi marrë vesh që të gjithë përfaqësuesit e partive politike për caktimin e lokacionit, dhe askund nuk e ka thënë që shkolla po bëhet me kornizën afatmesme buxhetore të Komunës. Mendoj që nuk është mire me thënë të pavërteta.

Shefket Kolgeci - është e vërtetë që kemi formu komision për fshatin Budakovë dhe Vraniq rreth marrëveshjes për ujdi për ujë. Kemi pas takim në Budakovë dhe në Vraniq. Gjërat nuk kanë shku keq. Shkaku që su realizu ai projekt, është se ishte vit i fundit zgjedhor, u ndërru Asamblea dhe ai komision ka mandate vetëm për atë kohe. Duhet të kyqemi në hidroregjion. Ka disa kundërshtime por shumica janë për. Besoj që kemi me arrit një marrëveshje sepse e vetmja zgjidhje është me hy në hidroregjion sikurse fshatrat tjera.

Kushtrim Kuçi - Kryetar kam nis me vërejt një veti të keqe në karakterin tend kohëve të fundit. Dole dhe the që performaca ka dal 500 mijë euro prej shtetit. Kohëve të fundit ki fillu mu krahasu me qytete e dobëta, e kjo është veti e keqe. Sepse dikur u krahasojshe me qytetet e forta. Ka raste që Peja i ka marrë 1700000 dhe Rahoveci ka dal dukshëm përpara. Kur ka dal performaca ti ke pas debat publik në RTK. Gazetari bëjke pyetje se pse ka dal performaca kaq keq dhe përgjigja ka qenë që na jemi qyteti i kampionëve. E që s'kishte lidhje me përgjigjen.

Mimoza Bajraktari - përshëndet të pranishmit. Po e shoh që Urimi po e cek disa here te dëgjimit publike. Tu kisha drejtu me pyetjen, pse nuk ke marrë pjesë? Në dëgjime publike aq sa e kam pa dhe kam marrë pjesë, jemi ne për mi dëgju dhe jo për ato që thu ti, që ju po tregoni përralla. Çdo Asamble i drejtohesh Kryetarit që po tregon përralla. Përrallat nuk kanë vite dhe nuk kanë numra fare. Pse drejtohesh me përralla kur jemi dëshmitar për punën që po bëhet. Pse mos me marrë pjesë në dëgjime publike. Edhe ti si qytetarë mi paraqit shqetësimet tua. Unë nuk e di pse bëhet politikë në Suharekë. Politika i takon nivelit qëndror. Po i marrim kohë edhe qytetarëve me debate të kota dhe ju kisha lut me qenë ma konkretë.

Kryetari - desha të them që su kanë Peja e para por Rahoveci. Komuna e Suharekës ka përfitu 8 kamiona nga Gizi gjerman.

Urim Suka - unë nuk kam pse me shku me ni debat publik, ku ju boni çka doni dhe si merrni mendimet e tona fare. E dyta, krejt asambleistat e AAK-së i kuptoj që janë me ni pozicion tepër të palakmueshm. I ka thirr asambleistat e AAK-së dhe i ka thënë: kta, kta keni me votu.

Mimoza Bajraktari - nuk ka nevojë mem ngre kërkush për hune. Flas në emër të gjithë asambleistave, sepse secili e kemi të drejtën me Kryetarin me iu drejtu dhe me debatu, edhe me kundërshtu, pse jo. Se të gjithë në koto ulëse jemi të barabartë dhe ia kemi marrë votën dikujt.

Aziz Bytyqi - është e vërtetë që po diskutojmë për një dokument të rëndësishëm dhe debatet janë të rëndësishme. Ajo që më shqetëson mua është nervozizmi, urrejtja në debat. Një pjesë e opozitës ia jep rëndësinë dokumenteve veq kur vin në Asamble, ndërsa proceduralisht dej sa të vin këtu, nuk merret me atë pjesë. Justifikimit, se unë nuk vi, se ju boni çka të doni, kjo është absurde. Duhet me shku dhe me marrë pjesë në debat dhe pastaj mundesh me thane që e ke propozu në emër të qytetarëve dhe nuk është pranë. Unë kam përshtypjen që krejt energjinë e shpenzoni ku mi gjet do defekte teknike, që kur të vje Asamblea mi thane dhe mundësisht mi pre shiritat ku flisni ju, kur të replikoni e jo me kan replikoni. Kjo në shkencë quhet tendencë për manipulim.

Urim Suka - dua ti them Azizit të jetë ma korrekt, sepse të njejtën nervozizëm e përdori edhe ky tash. Ne nervozizmin e patëm se shifrat s'ken kërkun. Ne jemi opozitë dhe unë i gjej gabimet e juaja dhe i adresoj tek qytetarët. Në një rast kur e kam pas me Azizin, ka dal, edhe unë kur kam fol, edhe Azizi kur ka fol. Ne e bëjmë opozitën si dimë ne.

Aziz Bytyqi - ne jemi mësimdhënës dhe ne duhet ta përfaqësojmë këtë status kudo që jemi.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

**14 për, 8 kundër, 1 apstenim
Miratohet pika 6.**

Pika 7. Pyetje dhe përgjigje

Shefket Kolgeci - dua ta pyes Drejtorin e Arsimit rreth shkollës së Vraniçit. A jemi gati, ku jemi dhe a do të kryhet sivjet? Drejtorit të Shërbimeve Publike: një pjesë e kanalizimit në Vraniq nuk funksionon. E kemi një Mulli, në vendin ku takohen dy lumenjtë, ka qenë teren i papërshtatshëm dhe puna ka qenë jashtëzakonisht e dobët. Kërkoj, ose me

dhanë përgjigje ose me bo sanim sepse momentalisht pjesa e sipërme e fshatit nuk janë të kyqun në kanalizim. Në kornizë për kanalizime disa fshatra ishin hy dhe fshati Vraniq nuk ishte aty. Keni mendu që u kry kanalizimi në Vraniq por faktikisht nuk u kry kanalizimi. Është rruga e Martirëve që nuk kanë kanalizim por dhe një pjesë mbi ta. Propozoj që edhe fshatin Vraniq me vendos për kanalizim.

Kryetari - ke të drejtë plotësisht me propozu. Problemi i shkollës në fshatin Vraniq, problem i anazave, problem i rrugës për Brezovicë, edhe ma tutje kompanitë që kanë kontrata dy vjeqare me Ministrinë s'kan fillu me punu. Për deri sa nuk e merr ni vendim Qeveria e R. Kosovës nuk fillojnë ato punë për arsye se kanë probleme të mëdhaja, e dini ngritjen e çmimit të naftës. Kryetari jep sqarime për kanalizimin në fshatin Vraniq. Sa i përket rrugës, është mire me bo kërkesë dhe mujm me rregullu sivjet sepse kemi trotuar në nivel të Komunës. Sa i përket ujit, është kompania shtetërore e hidrioregjionit që është mire me ja dorëzu.

Shefket Kolgeci - të kisha lut që kryesitë e fshatrave të kryhen sa ma shpejtë.

Sheqerije Zyrapi - përsëndet të pranishmit. Kam tre pyetje. Ku derdhen apo lidhen ujërat e zeza në Zonën Industriale dhe a ka projekt për kyçje? Si mund të zgjidhet problemi i parkingjeve për banorët që jetojnë nëpër banesa, sepse hasin në probleme të shumta, edhe denohen. Te sheshi "Besim Ndreca", tri shtylla elektrike prej druri, telat janë shumë të varura dhe ato kanë nevojë të ndërrohen dhe të vendosen me shtylla të betonit.

Kryetari - sa i përket shtyllave, duhet me bo kërkesën në Prishtinë sepse është pjesë e KEK-kut. Te parkingjet te cila pjesë po flet?

Sheqerije Zyrapi - parkingu te sheshi "Besim Ndreca". Kisha kërku me i bo disa tabela në dy anët e banesës për me tregu që është për banorët dhe hapsira tjetër të përdoret për parkingje.

Kryetari - nuk kemi të drejtë, pasi ajo prone është prone private e që në realitet nuk ka qenë private por e Komunës, lënda është në gjykatë.

Sheqerije Zyrapi - të gjitha banesat i kanë pas garazhdat, dhe tash janë hek garazhdat dhe tani është bo problem.

Kryetari - tash po e kuptoj për ku po flet. Aty mire është bo që janë largu.

Sanie Kuqi Rexhepaj - gjatë mandatit tim si Drejtoreshë e Urbanizmit kemi hartu një draft rregullore për menaxhimin e parkingjeve, e cila besoj shumë shpejt ka me u procesu në dëgjim publik dhe me ardh në Kuvend. Është trajtu edhe qështja e banorëve në objektet banesore, ku i kemi caktu që me iu dhënë prioritet banorëve me një kosto mujore të arsyeshme dhe me vlerë të ulët.

Kushtrim Kuçi - vitet tjera Komuna i ka praktikë shkollat për parkingje dhe tash dihet që është flugu më i madh sepse vin gurbetqarët. A keni me përdor këtë praktikë?

Kryetari - është një vendim. Në rend të parë e kemi rrit orarin e punës deri në ora 5 për ata që kanë me nxjerr dokumenta. Starton nga data 15 korrik dhe do jetë deri në fund të gushtit.

Selamn Kolgeci - pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike: A mund të na thonë çfarë po ndodh me ndërtimin e rrugës "Te Antena, te Quka dhe segmenti rrugës Ali Loshi" në Vraniq. Është hera e tretë që lidhet kontratë për këtë projekt. Si ka mundësi që pa as një vendim as të Kryesisë së fshatit të devijohet rruga dhe të ndërtohet rreth parcelave të një bashkëpartiaiku tuaj e duke përfunduar në një rrugë pa dalje?

Vraniqi problem jetik e ka furnizimin me ujë të pijes, zgjidhjen e problemit të varrezave dhe përfundimin e kanalizimit. Si ka mundësi që të vazhdoni të mos i kushtoni rëndësi kësaj kërkesë. A mund të na thoni se me çfarë procedura po guxon ti devijoni rrugët dhe a keni marrë miratim nga Kryesia e fshatit dhe banorët për këtë devijim? Nëse po, nga kush. Diskutimin publik se kemi bojkotu dhe skemi marrë pjesë për arsye tona personale. Meqenëse Kryesuesi nuk ma dha fjalën me përfundim diskutimin me Reshatin, Reshat të ftoj që diskutimin ta vazhdoj në rrjetet sociale meqenëse këtu po na mohohet e drejta për një gjë të tillë.

Kryetari - rruga është duke u punu në Vraniq, është rruga që lidhet me Bukosh, dhe është rrugë që pretendojmë mi hap dy hektar për varreza për një pjesë të Vraniqit, e cila është një parcelë komunale. Kryetari jep sqarime edhe rreth rrugëve në Vraniq.

Kryesuesi - i jep përgjigje Selmanit lidhur me të drejtën e fjalës dhe lexon rregulloren. Pra, për një pikë të rendit të ditës një here merret fjala, dhe nëse përmendet emri edhe një here i jepet fjala dhe më nuk ka të drejtë ta merr fjalën për atë pikë.

Selman Kolgeci - po thu që je tu e bo rrugën për te varrezat e reja, Qysh po do me na imponu varrezat? a ke fol me najkan? Vendimi për varrezat e vjetra po thu që është aktiv prej Asamblesë. Te Jeta Xharra iu ke përgjigj qytetarit dhe i ke thënë: ju vet keni marrë vendim, ju vet e keni shfuqizu.

Kryetari - njeri gjatë debateve mundet edhe me gabu. Kur është formu ai komision nuk kam qenë kryetar i Komunës. Ai komision është formu, ka stagnu dhe asnjëherë s'ka marrë vendime. Deri sa një vendim i Asamblesë është në fuqi nuk ka të drejtë Kryetari me shfuqizu, por atë vendim duhet me pru në Asamblenë Komunale me shfuqizu. Te Antena shokët e tu m'kan thirr dhe m'kan thane nale vitin e kalum, dhe nuk ka qenë e lehtë mi hap ato rrugë të reja, dhe asnjëherës keni dal asnja. E te kanalizimi ka plotësisht të drejtë sepse kurrë nuk është ndërto. Gypat janë të mire, shaktat janë të mire por plotësisht pajtohem që ka deviju.

Urim Suka - pyetje për Kryetarin:Disa muaj më pare është miratu strategjia për zhvillim ekonomikë lokal.Në këtë strategji parashihet që të investohet në ndriçim publik me panele solare.Afër vetes e kam edhe një kontratë që ju keni nënshkru për instalimin dhe sanimin e ndriçimeve publike.Në këtë kontratë ju keni parapa që të vazhdoni të instaloni ndriçim publik që bje në kundërshtim me strategjinë që e keni miratu vet.A mund të na sqaroni si do të jenë investimet në ndriçim publik,sipas asaj që parashihet në strategji apo sipas tekeve tua?

Kryetari - sipas tekeve të mia.Atë që e kam premtu,du me realizu.Jemi ka përfundimi i 37 fshatrave,tash ndriçimi shkon për Budakovë,Javor,Luzhnicë,Nishor.Prej një përvoje të Shtimes dhe Obiliqit,asnjëherë nuk kanë funksionu ndriçimi solar,unë e kam zgjedh kështu.

Urim Suka - Kryetar,para tre muaje e ke miratu strategjinë,ti e ke sponzorizu dhe ti e ke pru këtu.Sot po thu s'ban ajo,dhe po du me vazhdu qysh po du unë.

Kryetari - nuk thashë s'ban.Unë dje e nënshkruva edhe një kontratë,një donacion 56 mijë euro.

Urim Suka - disa mbledhje më pare në Asdamble kam ngritur disa shqetësime të qytetarëve të Bllacës për problemet që ata kanë me kanalizime dhe me ndriçimin publik.Në atë kohë përgjigja e Kryetarit ishte se nuk është aloku ende buxheti dhe sapo të alokohet këto probleme do të rregullohen.Mirëpo buxheti është aloku po këto problem ende nuk janë rregullu.Kur do të investohet në sanimin e problemeve të kanalizimit në fshatin Bllacë dhe Duhël,si dhe kur do të intervenohet në rregullimin e ndriçimit publik në Bllacë?

Kryetari - vet e ceke dhe the kontarta u bo me një qershor.Ne i kemi 42 fshatra,kem fillu sanimet nëpër fshatra dhe kur ti rregullojmë sanimet kem me fillu me ndriçim.Jam i informum për vërshimet në fshatin Bllacë.Kemi pas çdo vit vërshime dhe deri sa ujërat atmosferik i kanë drejtu në shakte,ajo ka me qenë vazhdimisht problem.

Urim Suka - edhe për pjesën e kanalizimit dhe ndriçimit nuk më dhe përgjigje.Për ndriçim në Bllacë,a ki me sanu dhe te kanalizimi,a do me nreq a s'do me nreq?

Kryetari - ka kërсит murmurima dhe një pjesë të madhe e ka hek prej përdorimit në Bllacë.Për kanalizim do mundohna qka të muj me bo,por nuk jap përgjigje adekuate, deri sa nuk e kam një kompani për pastrimin e kanalizimit.Kryetari tutje jep sqarime.

Flamur Bytyqi - Pyetje për Drejtorinë për Kulture,Rini dhe Sport:A ka mundësi me ditë pse nuk janë vizitu shumica e klubeve në Suharekë,me i pa për së afërmi.

Lorika Gashi - nëse nuk e ke ditë,në janar kur jam zgjedh,thuaje 99% e klubeve kanë ardh dhe më kanë vizitu.Çdo lojë që është lujtë jam taku me ta,qoftë si shikuese dhe qoftë si drejtoreshë.Thuaje secilin aktivitet kulturor dhe sportiv e kam përcjellë.Por mos ta harrojmë që ne e kemi edhe një pjesë tjetër,çështjen e administrates,çështjen e pagesave,e kontarteve e tendereve që duhet me nda kohë edhe për ato.

Flamur Bytyqi - a e ke taku klubin e shigjetarisë që po ushtron në kulme të banesave?A e ke taku klubin e futbollit Samadraxha dhe Studenqanin i cili është tërhek prej garave për 1 mijë euro.

Lorika Gashi - shigjetarinë dhe Studenqanin i kam taku.Samadraxhën jo.Për që është tërhek Studenqani unë nuk duhna me dhanë përgjegjësi për këtë punë. Dhe shigjetarinë e kam taku dhe jemi duke e organizu një garë e cila do të mbahet në gusht dhe ju ftoj publikisht me marrë pjesë.

Kushtrim Kuçi - kam shqetësim kundër zgjerimit të rrugës që e kanë bo qytetarët peticionin kundër rrugës Skëndërbeu.E di që keni mbajt takim publik me ta,dhe dua ta di a keni gjet zgjidhje si Komunë,për arsye që shqetësimi i tyre është që me u zgjeru rruga,bizneset e tyre që janë per rreth kanë me pas problem me zhvillu veprimtarinë.

Kryetari - pronat private asnjërit nuk i preket.Është një projekt,ka kalu në plan zhvillimor,janë nda mjetet dhe vazhdojmë me punë.Fillon impianti i ujërave atmosferike sepse çdo here ka pas problem ajo lagje.Kryetari tutje jep sqarime.

Takimi përfundoi: 12:20

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj